**VENDIM**
**Nr.559, datë 28.5.2009**

**PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR.191, DATË 22.3.2007 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR VENDOSJEN E OPONENCËS TEKNIKE SHTETËRORE PËR PROJEKTET E NDËRTIMIT TË HIDROCENTRALEVE, ME KONCESION", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.7961, datë 12.7.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, të ligjit nr.9367, datë 7.4.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën së Shqipërisë", dhe të ligjit nr.10025, datë 27.11.2008 "Për buxhetin e vitit 2009", me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pas pikës 7/1 të vendimit nr.191, datë 22.3.2007 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet pika 7/2, me këtë përmbajtje:

"7/2 Pagesa e grupit të ekspertëve, për periudhën 1 janar 2009 deri më 30 qershor 2009, në shumën 6 180 000 (gjashtë milionë e njëqind e tetëdhjetë mijë) lekë, të përballohet nga fondi (30 për qind), që Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës ka përfituar, në vitin 2008, nga të ardhurat jashtë limitit, nga privatizimi i pronës publike, në zbatim të vendimit nr.1638, datë 17.12.2008 të Këshillit të Ministrave "Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore, që privatizohet apo transformohet, dhe për procedurën e shitjes"."

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 janar 2009.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**